

## 5. ORGANIZIMI I USHTRISË NACIONALÇLIRIMTARE DHE I KRYENGRITJES SË PËRGJITHSHME POPULLORE

Pas Konferencës I të Vendit puna politike dhe organizative e Partisë u përqendrua kryesisht në përgatitjen e popullit për kryengritjen e përgjithshme, në radhë të parë për organizimin e Ushtrisë Nacionalçlirimtare.

Partia i bëri thirrje popullit shqiptar, punëtorëve, fshatarëve, qytetarëve, rinisë, grave, nacionalistëve e intelektualëve patriotë, për të bashkuar të gjitha forcat dhe për t'i vënë në shërbim të luftës kundër pushtuesve fashistë e tradhtarëve, për të hyrë sa më shumë në radhët partizane, me qëllim që të krijoheshin reparte të reja, të forcohej lufta e armatosur dhe të shkohej kështu drejt kryengritjes së përgjithshme. «Fati i vendit tonë, — e mësonte Partia popullin, — varet nga lufta që po bëjmë dhe sa më e gjerë dhe e ashpër do të jetë kjo luftë kundrejt zaptuesit, aq më e shpejtë do të jetë dita e çlirimit»<sup>1</sup>.

Duke demaskuar propagandistët ballistë që trumbetonin në të gjitha anët se shqiptarët nuk mund të luftonin dot dhe as që duhej të luftonin kundër Italisë, pasi atë do ta shkatërronin aleatët dhe do t'i sillnin lirinë e pavarësinë edhe Shqipërisë (!), Enver Hoxha shkruante në «Zërin e popullit»: «Ç'ngjet po të arsyetonin gjithë bota si këta «politikanë të mëdhenj»?... Ngjet një gjë shumë e thjeshtë që... Shqipëria e vogël... bëhet për jetë raja e Musolinit...

Një për të gjithë e të gjithë për një. Rusia, Anglia, Amerika e bëjnë luftën me ushtri të mëdha, me tanke e aeroplanë, por kjo s'ekskludon që ne ta bëjmë luftën me atë pushkën e vetme që kemi... Lufta s'bëhet me trëndafila dhe as me pambuk, dhe liria s'fitohet me fjalë dhe as me kompromise, por me vuajtje e gjak»<sup>2</sup>.

Krahun veprimtarisë së gjerë politike me masat e popullit, komunistët e shtuan punën e tyre ilegale në radhët e ushtarëve, të xhandarëve e të policëve shqiptarë, në radhët e gjithë njerëzve të gënjyer që ishin në shërbim të pushtuesit,

---

1 Dokumente kryesore të PPSH, vëll. I, f. 149.

2 Enver Hoxha. Vepra, vëll. 1, f. 246-247.

si edhe në radhët e ushtarëve e të punëtorëve italianë që ndodheshin në Shqipëri. Ndërmjet këtyre të fundit shpërnda-heshin trakte italisht.

Në përgjigje të thirrjes së Partisë dhe si pasojë e vep-rintarisë së dëndur të komunistëve, me qindra luftëtarë të rinj mbushnin radhët e çetave partizane. Një pjesë e madhe e nxënësve të shkollave të mesme dolën në mal dhe u bashkuan me luftëtarët e lirisë. Me partizanët u bashkuan gjith-ashtu patriotë që dezertuan nga formacionet ushtarake ar-mike. Brenda më pak se tre muajve numri i partizanëve u dyfishua. Në maj 1943 u formuan batalionet e para si edhe shtabet e para të qarqeve. Deri në korrik në Shqipëri kishte 20 batalione dhe 30 çeta partizane.

### **Shkatërrimi i fraksionit në qarkun e Vlorës**

Kur e gjithë Partia ishte e zë-në me zbatimin e detyrave të Konferencës I të Vendit për përgatitjen e kryengritjes së përgjithshme, armiqtë e popu-llit e të komunizmit, Sadik Premtja e Pali Tërova kurdisën nën rrogos në qarkun e Vlorës një fraksion armiqësor kundër PKSH. Në të vërtetë ata e kishin filluar përgatitjen e këtij fraksioni pikërisht kur drejtuesit kryesorë të Partisë në qark genë larguar për në Konferencën I të PKSH. Duke përfituar nga kjo dhe nga mungesa e një vigjilence, disipline dhe për-gatitjeje marksiste-leniniste të shëndoshë në radhët e komu-nistëve, ata mundën të mashtronin e të bënin me vete një nu-mër anëtarësh partie, si edhe komandën e çetës partizane «Plakë» të Vlorës. Në prill fraksionistët shpallën se nuk e njih-nin Komitetin Qarkor të Partisë dhe hodhën parullën për thirrjen e një të ashtuquajture «konferencë partie», e cila do të rrëzonte Komitetin dhe do të zgjidhte një qarkor të ri me Sadik Premten dhe shokët e afërt të tij.

Fraksioni armik i kishte vënë vetes synim të merrte në dorë frenat e organizatës së Partisë, si edhe komandën e çe-tave partizane të qarkut të Vlorës, të shfaroste komunistët e vendosur, në radhë të parë kuadrot udhëheqës, të asgjësonte luftën çlirimtare në qark, pastaj të vazhdonte më tej punën shkatërruese në krahinat e tjera të vendit, të rrëzonte Komi-tetin Qendror dhe të asgjësonte Partinë Komuniste. Tradh-tarët kishin rënë në marrëveshje me krerët e Ballit Ko-mbëtar për të vepruar së bashku në arritjen e qëllimit të

caktuar. Me dredhi dhe shpifje, duke pasur mbështetjen e ballistëve, ata u përpoqën të ngrinin më këmbë popullsinë fshatare për të goditur me armë Partinë dhe çetat partizane. Njëkohësisht iu dërguan letra një vargu komunistësh në qarqet e ndryshme si edhe Komitetit Qarkor të Gjirokastrës. Në to paraqiteshin gjoja si arsye të revoltimit vendimet «e padrejta» që kishte marrë Partia kundër A. Lulës, S. Premtes dhe fraksionistëve të tjerë dhe kërkohesh mbështetje.

Gjendja e rëndë e krijuar në organizatën e partisë të qarkut të Vlorës me të drejtë u vlerësua nga Komiteti Qendror si një rrezik i madh për gjithë Partinë. Për të drejtuar luftën kundër fraksionit shkoi në vend Sekretari i Përgjithshëm Enver Hoxha.

Lufta për asgjësimin e fraksionit u organizua me parullën «Partia mbi të gjitha». Shoku Enver Hoxha së bashku me shokët Hysni Kapo e Mehmet Shehu, sekretarë të Komitetit Qarkor, në mbledhje e takime individuale sqaruan në radhë të parë anëtarët e partisë për qëllimin e vërtetë dhe për rrezikshmërinë e madhe të veprimtarisë armiqësore të fraksionit. Gati të gjithë komunistët e gënjer nga tradhtarët e kuptuan thellë fajin dhe shkëputën çdo lidhje me ta. Për tradhtinë e S. Premtes u ndriçua edhe populli i krahinës së Vlorës e të Mallakastrës, i cili tok me Partinë mori pjesë gjallërisht në shkatërrimin e fraksionit. Në maj çdo gjë kishte marrë fund. S. Premtja, i demaskuar si armik i popullit dhe i Partisë, mundi të shpëtonte duke u larguar në Vlorën e pushuar nga fashistët italianë.

Pas likuidimit të fraksionit armik në qarkun e Vlorës, në qershor 1943, Komiteti Qendror i Partisë me një qarkore të posaçme, ku zbuloheshin rrënjët dhe qëllimi i këtij fraksioni, i porosiste gjithë komunistët: «Ky pësim duhet të jetë një mësim për gjithë organizatat e partisë e sidomos për organizatën e Vlorës... Lufta jonë kundër këtyre armiqve të poshtër duhet të bëhet me ashpërsinë më të madhe,... duhet t'i urrejmë këta njerëz dhe pa mëshirë t'i godasim, kudo që t'i gjejmë e në çdo rast që manifestohen»<sup>1</sup>.

---

<sup>1</sup> Qarkore e KQ të PKSH, 17 qershor 1943. Dokumente kryesore të PPSH, vëll. I, f. 172-173.

Ngjarja e Vlorës u bë me të vërtetë mësim për gjithë Partinë. Ajo ndihmoi që komunistët të kuptonin më thellë rrezikun që paraqitnin armiqtë e Partisë, të forconin disziplinën, të rritnin vigjilencën dhe frymën luftarake në veprimtarinë e tyre revolucionare. Deri në fund të luftës të tilla ndodhi, si ajo e Vlorës, nuk u përsëritën më.

## **Krijimi i Shtabit të Përgjithshëm**

Në kohën kur Partia luftonte për të asgjësuar fraksionin e S. Premtes, në të gjitha anët e vendit partizanët e vullnetarët u jepnin goditje të njëpasnjëshme pushtesve fashistë. Më të fuqishmet nga këto ishin sulmet kundër trupave italiane në afërsi të minierës së Selenicës (prill 1943), në Leskovik (maj), në rrugën Strugë-Dibër (qershor), në Përmet—Kuqar—Grykë e Mezhgoranit—qafë e Këçokut (fillimi i korrikut). Më 6 korrik partizanët shqiptarë kryen edhe goditjen e parë kundër trupave gjermane në Barmash mbi rrugën Korçë—Janinë. Në të njëjtën kohë repartet partizane së bashku me popullsinë fshatare përballuan operacionet ushtarake që zhvilluan fashistët italianë në Kurvelesh e Mesaplik (prill), në Pezë, Mallakastër, Tepelenë e Shpirag (qershor). Në këto operacione pushtesit hodhën divizione të tëra kundër partizanëve e popullit. Ata masakruan mijëra gra, burra, pleq e fëmijë, dogjën qindra fshatra, grabitën kope të tëra bagëtish, por nuk nxorën asnjë përfitim ushtarak e politik. Përkundrazi e ndezën edhe më shumë urrejtjen e zemërimin e popullit.

Në gjendjen e një vrulli revolucionar të jashtëzakonshëm që kishte pushtuar gjithë vendin, Komiteti Qendror i PKSH i propozoi Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar të merrte në shqyrtim problemet e luftës kundër fashizmit që kërkonin zgjidhje të ngutshme. Problemi më kryesor ishte organizimi i Ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare.

Mbledhja e Këshillit të Përgjithshëm u mbajt më 4 korrik 1943 në Labinot. Aty u vendos njëzëri formimi i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Sekretari i Përgjithshëm i PKSH, Enver Hoxha, u zgjodh komisar politik i Shtabit. Më 10 korrik Këshilli dhe Shtabi njoftuan popullin me një proklamata të posaçme për këtë ngjarje të rëndësishme.

Shtabi i Përgjithshëm bëri organizimin e Ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare (UNÇSH) dhe përqendroi në duart

e tij udhëheqjen strategjike e operative të luftës së armatosur kundër pushtuesve e tradhtarëve, duke përpunuar njëkohësisht edhe taktikën e kësaj luftime. Për centralizimin e drejtim të reparteve partizane në krahinat u krijuan shtabet e qarqeve dhe Shtabi i Zonës I Operative. Më 15 gusht 1943 u inaugurua Brigada I Sulmuese. Komandant i saj u emërua shoku Mehmet Shehu.

Në kohën kur u formua Shtabi i Përgjithshëm, UNÇSH përfshinte në gjirin e vet rreth 10 mijë luftëtarë të organizuar në reparte partizane të përhershme. Një numër afërsisht dy herë më i madh luftëtarësh bënte pjesë në çetat territoriale të fshatrave të çliruara dhe në njësitet guerile të qyteteve e të krahinave të pushtuara.

Një masë tjetër shumë e rëndësishme e Shtabit të Përgjithshëm qe organizimi i pushtetit ushtarak partizan të prapavijave. Si organe të këtij pushteti u krijuan «komandat e qarkut» dhe «komandat e vendit». Këto organe kryenin detyrat e policisë popullore në zonat e çliruara, si mbështetje e shëndoshë dhe ndihmëse të këshillave nacionalçlirimtare e të reparteve partizane.

Me krijimin e Shtabit të Përgjithshëm lufta e armatosur hyri në një fazë të re, në fazën e një organizimi më të lartë dhe të zgjerimit të vrullshëm, në fazën e kryengritjes së përgjithshme popullore. Anëmbanë vendit repartet e Ushtrisë Nacionalçlirimtare dhe çetat territoriale së bashku me masat e popullit u hodhën në përleshje me forcat e armatosura italiane të pushtimit dhe me forcat gjermane që kishin filluar të hynin e të lëviznin në tokën shqiptare. Derisa ushtritë e pushtuesve italianë e gjermanë, urdhëronte Shtabi i Përgjithshëm, «të mos kapitullojnë pa kondita, derisa në tokën e atdheut tonë të dashur të ndodhet edhe një fashist me armë në dorë, lufta jonë duhet të vazhdojë me ashpërsinë më të madhe»<sup>1</sup>.

Në korrik, gusht e fillimi i shtatorit ashpërsia e luftës çlirimtare kundër pushtuesve italianë arriti kulmin. Operacionet e reja ushtarake që organizuan ata në Mallakastër e Tepelenë përfunduan me dështim të turpshëm. Luftime të përgjakshme

---

1 Urdhër, 30 korrik 1943. Dokumente të Shtabit të Përgjithshëm dhe Komandës së Përgjithshme të UNÇSH, vëll. I, 1976, f. 32.

zhvilloi UNÇSH tok me popullin e armatosur kundër ushtrisë pushtuese fashiste në Pojskë të Pogradecit; në Burrel, në Qafën e Shtamës e në Qafën e Buellit (Mat); në Zerqan e Sofraçan të Dibrës; në Kardhiq, Mashkullorë, Libohovë e Konispol të qarkut të Gjirokastrës; në Llogara e Tragjas të Vlorës; në Vitkuq të Korçës; në Reç të Shkodrës; në rrugën Elbasan—Tiranë etj.

Të frikësuar nga kryengritja që shpërtheu në mbarë vendin, pushtuesit fashistë në korrik e shpallën gjithë tokën shqiptare zonë operacionesh. Kryekomandanti italian ishte i shtrënguar të pohonte se «populli shqiptar në shumicën e tij dhe pa dallim klase është ngritur kundër Italisë dhe kundër qëndrimit të trupave tona në Shqipëri»<sup>1</sup>. Ai i kërkonte qendrës së tij në Romë të shtojë numri i forcave pushtuese për t'i bërë ballë gjendjes së krijuar në vend.

## **UNÇSH — ushtri popullore revolucionare**

Nëpërmjet Shtabit të Përgjithshëm Partia Komuniste vuri në zbatim në mënyrë

më të plotë mësimet marksiste-leniniste mbi kryengritjen e armatosur popullore në kushtet e Shqipërisë dhe zgjidhi problemet themelore ushtarako-politike dhe organizative të UNÇSH.

Edhe pas krijimit të Shtabit të Përgjithshëm ushtria çlirimtare ishte e detyruar të zhvillonte kryesisht luftë partizane kundër armiqve, për arsye të epërsisë që kishin forcat e armatosura të pushtimit në numër, sidomos në teknikë luftarake, në municione, mjete transporti e ndërlidhjeje, në ushqime e veshmbathje. Lufta frontale në këto kushte do të ishte vdekje për kryengritjen e armatosur popullore.

Veprimet luftarake të reparteve e të njëjësive partizane kishin karakter sulmues, zhvilloheshin pa ndërprerje, dalloheshin nga përdorimi me mjeshtëri i manovrës së shkathët dhe i befasisë, nga iniciativa e madhe e komandave të brigadave, të grupeve e batalioneve, nga shfrytëzimi i përsosur i terrenit.

UNÇSH me luftën e saj partizane zgjidhte edhe detyra të pavarura strategjike. Asaj i kishte ngarkuar Partia si mision të çlironte gjithë vendin me forcat e veta, njëkohësisht

---

1 Comando 9-a armata. Notizie mensile, Nr. 8, agosto 1943.

të siguronte vendosjen e pushtetit popullor dhe të shërbente si mbështetje e armatosur e këtij pushteti.

Detyra të tilla mund t'i plotësojë vetëm një ushtri e rregullt. Kjo është arsyeja që PKSH bëri aq shumë përpjekje për krijimin e UNÇSH dhe për shndërrimin e saj në ushtri të rregullt të popullit shqiptar.

Si formacioni më i madh i ushtrisë së rregullt popullore në fillim u caktua brigada. Shtabi i Përgjithshëm hartoi një plan të posaçëm për krijimin e një vargu brigadash njëra pas tjetrës, të cilat do të përmblihdnin shkallë-shkallë pjesën më të madhe të çetave, të batalioneve e të grupeve nëpër qarqet.

Me organizimin e UNÇSH dhe me rritjen e saj pa ndërprerje rritej edhe nevoja për kuadro ushtarakë e politikë. Partia s'kishte kuadro të tillë të gatshëm. Shtabi dhe Këshilli i Përgjithshëm në kushtet e luftës nuk kishin mundësi të hapnin shkolla për përgatitje oficerësh. Komandantët e komisarët përgatiteshin në zjarrin e luftës së ashpër kundër armiqve nga radhët e punëtorëve, fshatarëve e intelektualëve patriotë, nga partizanët më të ndershëm, më trima dhe më besnikë ndaj popullit e atdheut.

Si burim kryesor për furnizimin e partizanëve me armë e municione, edhe pas krijimit të Shtabit të Përgjithshëm e deri në fund të luftës, mbeti armiku, ushtria dhe depot e pushtuesve, të cilëve u rrëmbeheshin me luftë.

Për sa i përket furnizimit të reparteve e njërive të UNÇSH me veshmbathje e ushqime, këto siguroheshin kryesisht nga ndihmat e popullsisë së qytetit e sidomos të fshatit dhe pjesërisht i merreshin armikut me luftë. Strehimi i partizanëve bëhej në shtëpitë e fshatarëve dhe qytetarëve të zonave të çliruara.

Një rëndësi të dorës së parë i dha Partia mbajtjes lart të moralit në ushtri. Çdo partizan ishte i gatshëm të jepte jetën për lirinë, për atdheun, për Partinë Komuniste. Kjo forcë morale i kishte rrënjët në ndërgjegjen e lartë të luftëtarëve. Ata e dinin mirë përse luftonin, e kuptonin thellë drejtësinë e vijës politike të Partisë, ishin plotësisht të vetëdijshëm për vështirësitë, privacionet dhe theroritë që kërkonte lufta, kishin besim të patundur në fitoren e çështjes që mbronin.

Figurën morale të partizanit e ngrinin edhe më lart disiplina e ndërgjegjshme, dashuria për popullin, dashuria për shokun, ndershmëria e thellë dhe sjellja shembullore ndaj po-

pullsisë, kujdesi shumë i madh për ruajtjen e zakoneve dhe traditave të mira të vendit.

Cilësitë e larta moralo-politike dhe ushtarake të partizanëve ishin të qëndrueshme, sepse mbështeteshin në bindjen politike dhe në demokracinë. Ndryshe nga ushtritë e vjetra, mbrojtëse të interesave të klasave reaksionare, në UNÇSH luftëtarët e thjeshtë, njëlloj si komandantët e komisarët, gëzonin të drejta të barabarta dhe liri të plotë për të marrë pjesë në jetën politike të vendit dhe në zgjidhjen e problemeve ushtarake, politike e organizative të ushtrisë. Të gjitha veprimet luftarake të reparteve, puna politike, veprimtaria e komandave, sjellja e partizanëve dhe e kuadrove u nënshtroeshin gjykimit dhe kritikës së kolektivit. Urdhrat e komandave mishëronin kërkesat e luftëtarëve e të popullit. Për zbatimin sa më mirë të këtyre urdhrave, po ashtu dhe të vendimeve e direktivave të Partisë, organizohej rrahja dhe shkëmbimi i gjerë i mendimeve.

Demokracia në UNÇSH ishte shprehje e karakterit të saj si ushtri popullore dhe buronte nga parimi i rolit vendimtar që luajnë masat si farkëtuese të historisë.

Kjo demokraci nuk e dobësonte aspak disiplinën ushtarake, por e forconte dhe e bënte atë më të ndërgjegjshme; nuk e cënonte udhëheqjen e centralizuar, por ndihmonte në realizimin e saj.

Përdorimi me mjeshtëri i kërkesave të taktikës së luftës partizane dhe morali shumë i lartë në UNÇSH krijojnë mundësinë për të neutralizuar dhe kapërcyer epërsinë në numër e në teknikë luftarake të armiqve.

Farkëtuese e cilësive të larta moralo-politike e ushtarake të luftëtarët e UNÇSH ishte Partia Komuniste.

Udhëheqës të punës politike të partisë ishin komisarët e brigadave, grupeve, batalioneve e kompanive (çetave). Komisari ishte njëkohësisht anëtar i komandës së repartit partizan. Zëvendëskomisarët kryenin detyrën e sekretarëve të Partisë. Për të zhvilluar punën politike në Ushtri Partia dërgoi aty një pjesë të madhe nga kuadrot e saj më të mirë.

Krahas organizatave të partisë në ushtri u krijuan organizatat e Rinisë Komuniste, si ndihmëse të organeve dhe celulave të partisë.

Komisarët, zëvendëskomisarët, organizatat e partisë e të rinisë zhvillonin një punë të madhe edukuese politike në re-



partet partizane, siguronin rolin pararojë të komunistëve dhe të rinjve komunistë në kryerjen e detyrave luftarake. Ata edukonin luftëtarët me frymën e patriotizmit e të besnikërisë ndaj atdheut, ndaj popullit, ndaj Partisë Komuniste, me traditat luftarake revolucionare të popullit shqiptar, me idetë e marksizëm-leninizmit, me parimet e internacionalizmit proletar, me frymën e dashurisë për të gjithë popujt që luftonin kundër fashizmit. Ata rrënjosnin në mendjen e partizanëve dhe të popullit bindjen për fitoren, siguronin zbatimin e urdhrave të Shtabit të Përgjithshëm dhe të komandave partizane.

Partia Komuniste gëzonte besimin dhe autoritetin më të lartë në radhët e luftëtarëve dhe të kuadrove të UNÇSH. Një besim dhe autoritet të tillë Partia e kishte fituar nëpërmjet shembullit që jepnin në luftë e në sjellje komunistët.

Të gjitha çështjet e ndërtimit, të strategjisë, të taktikës dhe të veprimeve luftarake të ushtrisë zgjidheshin në bazë të direktivave dhe udhëzimeve të Komitetit Qendror. Enver Hoxha, Sekretar i Përgjithshëm i Partisë, ishte organizatori, udhëheqësi dhe mësuesi kryesor i UNÇSH.

Krijimi i UNÇSH ishte një fitore e madhe politiko-usharake e Partisë. PKSHP mundi të zgjidhte kështu një nga detyrat e saj më vendimtare dhe më të vështira.

## **Demaskimi i patriotizmit të rremë të Ballit Kombëtar**

dër pushtuesve e tradhtarëve, por edhe nëpërmjet një lufte të ashpër politike me reaksionin e brendshëm, me Ballin Kombëtar.

Për të sabotuar luftën e armatosur kundër pushtuesve, Balli Kombëtar përdori të gjitha mjetet dhe mënyrat që përdorin armiqtë e popullit e të revolucionit: shpifjen, demagogjinë, trembjen me «gogolin komunist», kanosjen, intrigat, gënjeshttrat, premtimet, vrasjet me të pabesë të komunistëve, të partizanëve e të anëtarëve të këshillave, marrëveshjet e fshehta me pushtuesit për bashkërendimin e veprimeve kundër forcave revolucionare etj. Në disa raste ballistët arritën të mashtronin fshatra të tëra. Kishte fshatarë, të shtyrë e të kërcënuar nga Balli, që nuk pranonin strehimin e partizanëve në katundet e tyre, kundërshtonin të goditnin me armë ushtri-

në italiane gjatë operacioneve, nuk njihnin këshillat nacionalçlirimtarë.

Raste të tilla, po qe se nuk do të ngelnin të kufizuara, do të çonin në neutralizimin e fshatarësisë, bazës dhe burimit më të madh të forcave të Luftës Nacionalçlirimtare, si pasojë do të rrezikohej fitorja e kësaj luftime. Ky rrezik u mënjanua me qëndrimin dhe veprimet e vendosura e të peshuara mirë të Partisë, të mbështetura në njohjen e thellë të kushteve objektive, të gjendjes konkrete brenda në vend.

Shumica dërrmuese e fshatarësisë donte të luftohej kundër pushtuesve për çlirimin e atdheut. Këtë kërkesë e plotësonte me vepra të përditshme vetëm Partia Komuniste. Balli Kombëtar ishte kundër luftës me fashistët. Ky qëndrim i tij vinte në kundërshtim me dëshirat dhe kërkesat e fshatarëve e të popullit në përgjithësi.

Në pranverë të vitit 1943 një numër fshatarësh, të mashtruar nga krerët ballistë, dëgjuan «këshillat» e tyre dhe nuk i pritën me pushkë trupat operuese italiane, as nuk u larguan kur ata hynë në fshatrat e tyre, duke kujtuar se fashistët me të vërtetë nuk do t'i preknin. Mirëpo këta i dogjën fshatrat pa bërë asnjë dallim dhe masakruan barbarisht gratë, burrat e fëmijët që s'ishin larguar. Ky ishte një mësim i hidhur për gjithë njerëzit e gënjyer nga reaksioni.

Balli Kombëtar, për të shkatërruar Frontin Nacionalçlirimtar, afrohej gjithnjë e më shumë me pushtuesit dhe mernte pjesë tok me ta në veprimet kundër këshillave dhe çetave partizane. Bandat balliste e ndihmuan drejtpërdrejt ushtrinë italiane në operacionet e saj ndëshkuese kundër partizanëve dhe popullit. Populli e priti me zemërim këtë qëndrim të ballistëve.

Partia Komuniste u doli krah fshatarëve në luftën e tyre kundër grabitjes së drithit, të bulmetit, të leshit nga fashistët. Ndërkaq, ballistët jo vetëm këshillonin të mos bëhej kundërshtim për t'u dorëzuar pushtuesve e qeverisë kuislinge prodhimet bujqësore, por edhe i ndihmonin armiqtë në grabitjen e fshatarëve. Këto veprime të Ballit i largonin gjithnjë e më shumë masat prej tij.

Partia Komuniste nëpërmjet një pune të gjerë politike propagandonte vijën e saj, programin e Frontit Nacionalçlirimtar, demaskonte manovrat e skllavëruesve fashistë e të tradhtarëve, zbulonte përmbajtjen dhe qëllimin e vërtetë të çdo

veprimi dhe qëndrimi antikombëtar dhe antipopullor të krerëve dhe të çetave balliste.

Kështu fshatarësia u bind dalngadalë nga përvoja e saj se vetëm nën udhëheqjen e Partisë Komuniste mund të arrihej fitorja e vërtetë kundër pushtuesve fashistë e tradhtarëve. Ajo po e kuptonte gjithnjë më thellë se ëndrrat e saj shekullore për liri e tokë mund t'ia plotësonte vetëm Partia, ndërsa Balli nuk ishte për zhdukjen e shtypjes dhe të shfrytëzimit.

Sa më tepër demaskohej demagogjia dhe tradhtia e Ballit Kombëtar aq më shumë fshatarët dhe shtresat e tjera të popullit afroheshin rreth Partisë. Anëmbanë Shqipërisë masat popullore e vinin në tallje Ballin me fjalët «Prit gomar të mbi-  
jë bar, kështu thotë Balli Kombëtar» dhe e mbiqajtën atë «bishti kombëtar».

## **Dënimi i marrëveshjes së Mukjes**

Gjendja e krijuar kërkonte të bëhej ç'ishte e mundur për të mënjeluar luftën vëllavrasëse, të cilën e nxitnin me mënyra të ndryshme pushtuesit fashistë. Me propozim të Komitetit Qendror të PKSH kjo çështje u shqyrtua në mbledhjen e Këshillit të Përgjithshëm të korrikut 1943. Këshilli vendosi të bëhej edhe një përpjekje e fundit për ta larguar Ballin Kombëtar, si organizatë, nga rruga e tradhtisë dhe për ta tërhequr atë në Luftën Nacionalçlirimtare. Për këtë u ngarkua një delegacion që do të zhvillonte bisedime me krerët e Ballit mbi këto çështje. Balli Kombëtar të hyjë menjëherë në luftë kundër pushtuesit e të pushojë luftën kundër Lëvizjes Nacionalçlirimtare e Partisë Komuniste të spastrojë radhët e veta nga fashistët, kugarët e kriminelët të pranojë këshillat nacionalçlirimtarë me luftë e me përpjekje kundër fashizmit të arrihet në mbajtjen e një konference kombëtare, ku të marrë pjesë edhe Balli Kombëtar e ku të shtrohen e të zgjidhen të gjitha çështjet e bashkimit.

Takimi i parë me krerët e Ballit u bë në Tapizë afër Tiranës, kurse i dyti në Mukje afër Krujës më 1-2 gusht.

Ballistët pranuan të takoheshin me delegacionin e Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar vetëm me qëllim që të forconin pozitat e tronditura thellë nga demaskimi i tradhtisë së tyre dhe të siguronin pushtetin politik me kapitullimin e Italisë, që, pas rrëzimit të Musolinit më 25 korrik, dukej qartë se ishte një çështje ditësh.

Në bisedimet e zhvilluara, Ymer Dishnica, anëtar i Byrosë Politike të Komitetit Qendror, që udhëhiqte delegacionin, u gjuhëzua përpara presionit dhe demagogjisë së borgjezisë reaksionare e të çifligarëve. Në vend që të mbronte me këmbëngulje vijën e Partisë Komuniste dhe qëndrimin e drejtë që Këshilli i Përgjithshëm kishte vendosur të mbahej ndaj Ballit Kombëtar, ai pranoi një marrëveshje të atillë në Mukje që vinte në kundërshtim të drejtpërdrejtë me interesat e Luftës Nacionalçlirimtare e të popullit shqiptar. Një rol tepër negativ në këtë punë luajti Mustafa Gjinishi, anëtar i delegacionit, i cili u tregua përkrahës i flaktë i kërkesave të borgjezisë reaksionare.

Marrëveshja e Mukjes e nxirrte Ballin Kombëtar, që kishte sabotuar Luftën Nacionalçlirimtare dhe i kishte ndihmuar me mënyra të ndryshme pushtuesit, si një luftëtar kundër fashizmit, njësoj si Frontin Nacionalçlirimtar. Në vend që të kërkonin të hynte Balli Kombëtar në luftë kundër pushtuesve, Ymer Dishnica e Mustafa Gjinishi pranuan kërkesën demagogjike balliste për «shpalljen e pavarësisë» dhe rrëzimin e «asamblesë fashiste të 12 prillit», në të cilën kishin bërë pjesë gati gjithë krerët e Ballit dhe që populli nuk e kish njohur kurrë. Ata pranuan parullën e rreme të «Shqipërisë etnike» që fashizmi dhe reaksioni e përdornin si armë për ta mashtruar popullin shqiptar që të harronte armikun kryesor në atë kohë dhe të armiqësohej me popujt fqinj. Ata pranuan propozimin e reaksionit të krijohej një «Komitet për Shpëtimin e Shqipërisë», me një numër të barabartë përfaqësuesish nga Balli Kombëtar dhe nga Fronti Nacionalçlirimtar. Komiteti do të pajisej me atributet e një qeverie të përkohshme.

Këshilli i Përgjithshëm dhe në përgjithësi pushteti i këshillave nacionalçlirimtarë, pjella të luftës revolucionare të popullit, liheshin fare në harresë. Pa lejën e Këshillit të Përgjithshëm dhe të Komitetit Qendror të Partisë Ymer Dishnica e Mustafa Gjinishi dhanë pëlqimin të shpërndahej një proklamata e «Komitetit për Shpëtimin e Shqipërisë», me anën e së cilës i njoftoheshin popullit vendimet e Mukjes. Ata ranë kështu kryekëput në kurthin e reaksionit.

Partia Komuniste e Shqipërisë nuk ishte kundër çdo marrëveshjeje me Ballin Kombëtar. Ajo kishte bërë shumë përpjekje për ta tërhequr atë në luftë kundër pushtuesve dhe

mbi këtë bazë ta bashkonte me Frontin Nacionalçlirimtar; kishte zhvilluar bisedime, kishte pranuar formimin e «komisioneve të koordinimit» për luftë kundër fashizmit etj. Vendi i Këshillit të Përgjithshëm i korrikut 1943 për të zhvilluar bisedime me krerët ballistë ishte një përpjekje e fundit për ta tërhequr Ballin nga rruga e tradhtisë në atë të luftës kundër pushtuesve. Kjo përpjekje bëhej në interes të atdheut e të Luftës Nacionalçlirimtare. Kurse marrëveshja e përfunduar në Mukje i shkelte interesat e popullit dhe të atdheut. Ajo e çorientonte popullin, e largonte vëmendjen e tij nga lufta kundër pushtuesve dhe krijonte idenë e një bashkimi të rremë, të ndërtuar mbi bazën e pazarllëqeve nga lart. Marrëveshja e Mukjes u vinte kryq fitoreve të mëdha të arritura në luftën antifashiste nën udhëheqjen e Partisë Komuniste dhe, ç'ishte më keq, i hapte rrugën kalimit të pushtetit politik në duart e borgjezisë reaksionare, e cila nuk kishte hedhur asnjë pushkë dhe nuk mernte përsipër të luftonte kundër skllavëruesve të huaj, përkundrazi, kishte bashkëpunuar dhe bashkëpunonte me ta. Pra, një marrëveshje e tillë përbënte një tradhti ndaj popullit e revolucionit.

Për këtë arsye, me iniciativën e shokut Enver Hoxha, Komiteti Qendror dhe gjithë Partia e hodhën poshtë menjherë dhe pa ngurrim marrëveshjen e Mukjes.

Që kur mori njoftimin e parë, të shkruar me shprehje të errëta, Sekretari i Përgjithshëm i Partisë e kuptoi se në mbledhjen e Mukjes «orkestrën e kishte udhëhequr Balli» dhe, duke shprehur një shqetësim të madh, i tërhiqte vëmendjen Ymer Dishnicës: «...mos harro interesin e Partisë sonë, ajo duhet të jetë ashtu siç ka qenë: organizatorja dhe udhëheqësja e Luftës Nacionalçlirimtare dhe të mbetet e tillë e jo një fraksion në këtë luftë»<sup>1</sup>. Kur tradhtia u bë krejt e qartë, ai e quajti marrëveshjen «një kapitullim komplet përpara Ballit» dhe i shkruante Ymer Dishnicës: «*Ti ke rënë kokë e këmbë në pozitat e Ballit...*». Kjo marrëveshje që «shkel kryekëput vijën tonë politike, dënohet nga Komiteti Qendror»<sup>2</sup>.

---

1 Enver Hoxha. Letër drejtuar Ymer Dishnicës, 6 gusht 1943. Vepra, vëll. 1, f. 334.

2 Enver Hoxha. Letër drejtuar Ymer Dishnicës, 9 gusht 1943. Vepra, vëll. 1, f. 340.

Duke njoftuar komunistët për këtë shkelje të rëndë të vendimeve të Këshillit të Përgjithshëm dhe të vijës politike të Partisë, Komiteti Qendror shprehte qëndrimin e tij të prerë për të mos pranuar në asnjë mënyrë ndarjen e fryteve të luftës çlirimtare të popullit shqiptar dhe të pushtetit demokratik popullor me Ballin Kombëtar e me gjithë kundërshtarët e tjerë të kësaj lufte e të këtij pushteti.

Gjunjëzimi i Ymer Dishnicës dhe Mustafa Gjinishit i dha dorë Ballit Kombëtar ta shfrytëzonte marrëveshjen e Mukjes për luftën kundër Partisë Komuniste dhe për të mbjellë paqartësi në masat e popullit. Organizatave të partisë iu desh të bënin një punë të gjerë sqaruese për demaskimin e përmbajtjes reaksionare të asaj marrëveshjeje dhe të synimit të Ballit Kombëtar për të rrëmbyer frytet e luftës çlirimtare të popullit shqiptar me ndihmën e pushtesve.

**Këshillat nacionalçlirimtarë — i vetmi pushtet i popullit** Për forcimin e mëtejshëm të bashkimit të popullit shqiptar në luftën antifashiste u mbledh në Labinot, më 4-9 shtator 1943, Konferenca II Nacionalçlirimtare.

Konferenca kapi si hallkë kryesore çështjen e pushtetit demokratik popullor. Me thellimin e procesit revolucionar të luftës kjo çështje morri një rëndësi gjithnjë më të madhe, aq më tepër kur Balli Kombëtar dhe reaksioni në përgjithësi bënin të gjitha përpjekjet për të marrë pushtetin politik në duart e tyre.

Në këto kushte Konferenca hodhi parullën: «Të njihen këshillat nacionalçlirimtarë si i vetmi pushtet i popullit në Shqipëri»<sup>1</sup>.

Konferenca II Nacionalçlirimtare mori një varg masash për forcimin, zgjerimin e bazës demokratike dhe centralizimin e pushtetit popullor. Ajo e rriti Këshillin e Përgjithshëm nga 7 anëtarë (të zgjedhur në Konferencën e Pezës) në 62 anëtarë. Hartoi dhe pranoi Statutin dhe Rregulloren e këshillave nacionalçlirimtarë, dokumente këto me rëndësi kushtetuese. Në Këshillin e Përgjithshëm dhe në këshillat e qarqeve u vendos

---

<sup>1</sup> Rezolucioni i Konferencës II Nacionalçlirimtare, 8 shtator 1943. Dokumente të organeve të larta të pushtetit nacionalçlirimtar, f. 58.

të ngriheshin organet ekzekutive me aparatit e tyre administrativo-ekonomik.

Konferenca njohu organizatat e **Bashkimit të Rinisë Antifashiste, të Bashkimit të Grave Antifashiste, të Bashkimit të Universitarëve Antifashistë** (të krijuara pak kohë përpara nën udhëheqjen e Partisë Komuniste) si pjesë përbërëse të Frontit Nacionalçlirimtar dhe porositi që t'u jepej atyre ndihmë e përkrahje sa më e madhe. Këto ishin organizata që përfshinin masat e të rinjve e të grave prej klasave e shtresave të ndryshme të vendit dhe nuk kishin program tjetër veç atij të Frontit.

Në Konferencën e Labinotit u dënua botërisht marrëveshja e Mukjes si një akt që cenonte parimet themelore të Konferencës së Pezës dhe ishte kundër interesave të luftës e të bashkimit të popullit shqiptar.

Meqenëse Balli Kombëtar e vazhdoi veprimtarinë armiqësore në dëm të Lëvizjes Nacionalçlirimtare dhe bashkëpunimin me fashistët italianë, u vendos të mbahej kundrejt tij një qëndrim i prerë: të demaskoheshin deri në fund politika e tij antikombëtare, antipopullore, demagogjia e tij për bashkim, synimet e tij për të mbjellë përçarje dhe për të shkaktuar vëllavrasjen. Në të njëjtën kohë u dha udhëzim të mos hiqej dorë nga përpjekjet për të shfrytëzuar edhe mundësinë më të vogël për bashkëpunim me Ballin dhe rrymat e tjera politike jashtë Lëvizjes, por vetëm në bazë të platformës së Konferencës së Pezës dhe, para së gjithash, në bazë të pjesëmarrjes në luftën pa kompromis e pa ndërprerje kundër pushtesve si edhe të pranimit të këshillave nacionalçlirimtarë si i vetmi pushtet i popullit.

Një qëndrim i tillë do t'u hapte sytë njerëzve të mashtruar dhe do t'i shkëpuste nga krerët reaksionarë.

Konferenca e Labinotit nuk ushqe u ndonjë shpresë se Balli Kombëtar mund të hiqte dorë nga rruga e tradhtisë. Ajo i tregoi popullit se krerët ballistë po shkonin gjithnjë më larg në rrugën e bashkëpunimit me pushtesit dhe të luftës së hapur kundër Lëvizjes Nacionalçlirimtare.

Duke mbështetur vendimet e Konferencës së Labinotit, Komiteti Qendror i PKSH i porosiste komitetet qarkore: «...ta paraqesim mirë në popull Ballin si përçarës dhe shkaktar vëllavrasjeje, të bëjmë që populli ta shohë se politika e Ballit do të na shpjerë në përpjekje me armë, të bëjmë që populli i tëri të revoltohet për këtë gjë dhe kështu përgjegjësitë

historike... të bien, siç është e vërteta, ... mbi Ballin Kombëtar; të përgatitemi, të përgatisim të tërë ata të Lëvizjes Nacional-çlirimtare, të përgatisim popullin për një përpjekje me Ballin; Balli po e përgatit këtë përpjekje dhe nuk duhet të na gjejë me duar lidhur...»<sup>1</sup>

Ditën e mbarimit të Konferencës u mor vesh lajmi i kapitullimit të Italisë fashiste. Kjo ngjarje e ndryshoi gjendjen e mëparshme në Shqipëri. Në gjendjen e re Partisë Komuniste të Shqipërisë i dilnin detyra të reja.

## 6. PËR FORCIMIN E LUFTËS KUNDËR PUSHTUESVE TË RINJ GJERMANË DHE PËR SHPARTALLIMIN E REAKSIONIT

Kapitullimi i Italisë fashiste u shpall më 8 shtator 1943.

Populli shqiptar, i cili për katër vjet e gjysmë kishte bërë një luftë të ashpër për të hequr qafe zgjedhën e pushtuesve italianë, kishte dhënë drejtpërdrejt kontributin e vet të çmueshëm në këtë ngjarje.

### **Gjendja e re pas kapitullimit të Italisë dhe pushtimit të vendit nga nazistët gjermanë**

ose të bashkohej me UNÇSH kundër Gjermanisë hitleriane. Mirëpo kryekomandanti italian nuk iu përgjigj kësaj thirrjeje. Ai u dha urdhër trupave italiane në Shqipëri t'u dorëzoheshin gjermanëve. Këtë urdhër nuk e zbatuan vetëm rreth 15 mijë ushtarë e oficerë italianë, të cilët u dorëzuan tek UNÇSH. Partia Komuniste e Shqipërisë u kujdesua që të gjithë të dorëzuarit të priteshin gjithkund në mënyrë vëllazërore, pa marrë parasysh mizoritë që kishte kryer ushtria fashiste italiane në Shqipëri. Përgjegjësit kryesorë të këtyre mizorive duhej të jepnin llogari dhe të ndëshkoheshin rëndë kurdoherë që të kapeshin, gjatë luftës ose pas luftës.

Shtabi i Përgjithshëm, në përshtatje me marrëveshjen e kapitullimit, i bëri menjëherë thirrje armatës italiane të pushtimit ose të dorëzonte armët

---

<sup>1</sup> Direktiva të KQ të PKSH, 10 shtator 1943. Dokumente kryesore të PPSH; vëll. I, f. 196.



Prej ushtarëve italianë të dorëzuar në forcat e UNÇSH, rreth 1 500 veta pranuan të luftonin me armë në dorë kundër nazistëve gjermanë në radhët e reparteve partizane shqiptare. Në gjirin e Brigadës I Sulmuese të UNÇSH u formua batalioni «Antonio Gramshi». Ushtarët e tjerë që nuk dëshironin të luftonin u strehuan në zonat e çliruara të vendit, ku u pritën bujarisht nga fshatarët, me gjithë vështirësitë e jashtëzakonshme ekonomike që kalonin.

Vendin e pushtuesve italianë në Shqipëri e zunë agresorët gjermanë. Ata u pritën kudo me luftë të ashpër. Mbi rrugën Strugë—Librazhd, në Drashovicë afër Vlorës, te Ura e Kardhiqit afër Gjirokastrës, gjatë rrugës Elbasan—Tiranë, në Krujë, Konispol, Delvinë, Sarandë, Bilisht, gjatë rrugës Korçë—Leskovik dhe në vende të tjera repartet e Ushtrisë Nacionalçlirimtare u shkaktuan dëme të ndjeshme pushtuesve të rinj dhe nuk i lejuan të shtriheshin në gjithë territorin e Shqipërisë. Pjesa më e madhe e krahinave dhe një numër qytetesh mbetën të çliruara.

Pushtuesit gjermanë dislokuan në Shqipëri forca të armatosura prej rreth 70 mijë vetash. Me t'u vendosur këtu, ata i vunë vetes si detyrë të shuanin Lëvizjen Nacionalçlirimtare dhe ta bënin popullin shqiptar satelit të Gjermanisë. Për t'ia arritur këtij qëllimi nazistët përdorën në fillim një taktikë që synonte të maskonte regjimin e pushtimit dhe të mashtronte popullin me idenë e fitores së «pavarësisë kombëtare» dhe të «krijimit të shtetit shqiptar sovran». Ata shpallën me bujë se kishin ardhur «si miq», pikërisht «për ta çliruar Shqipërinë nga zgjedha e Italisë», se ushtria gjermane «do të garantonte pavarësinë e popullit shqiptar, po qe se ai do t'i jepte asaj ndihmë në luftë kundër komunizmit!»! Ata u bënë thirrje gjithë atyre që ndodheshin në male të dorëzonin armët e të ktheheshin nëpër shtëpi, meqenëse misioni i tyre ishte kryer plotësisht me ndihmën e ushtrisë gjermane! Hitlerianët i shtynë dhe i ndihmuan tradhtarët të shpallnin «ndarjen e Shqipërisë nga Italia» dhe të krijonin organet e «shtetit shqiptar të pavarur», si «komitetin ekzekutiv», «regjencën», «qeverinë shqiptare», «ushtarinë shqiptare», «gjindarmërinë shqiptare» etj. Kjo manovër u propagandua me bujë nga reaksionarët.

Por çfarëdo taktike të përdornin, hitlerianët nuk mund të mbulonin në asnjë mënyrë agresionin që kryen kundër Shqipërisë. Partia Komuniste ia kishte bërë të qartë me kohë po-

pullit shqiptar ç'armiq të egër të njerëzimit ishin nazistët gjermanë. Ditën që vunë këmbë për herë të parë në Shqipëri, në korrik 1943, ata rrafshuan krejt Borovën dhe shfarosën gjithë popullsinë e fshatit, edhe fëmijët e djetit.

As vetë gjermanët nuk ishin në gjendje të fshihnin vendosjen e një regjimi të egër pushtimi në Shqipëri. Krahas shpalljeve për «respektimin» dhe «garantimin» e pavarësisë kombëtare të Shqipërisë, ata nxorën shpalljet për çarmatosjen e gjithë popullsisë, për pushkatim dhe varje të 10 deri 30 shqiptarëve për çdo ushtar gjerman të vrarë, për çdo sabotim, për çdo armë a material ushtarak dhe ushqime të fshehura! U vendos kudo sistemi i shtetrrethimit. Regjenca dhe qeveria kuislinge nuk mund të merrnin asnjë vendim pa pëlqimin e komandës gjermane të pushtimit. Hitlerianët shtinë në dorë Bankën Kombëtare dhe gjithë burimet ekonomike të vendit.

Populli shqiptar nën udhëheqjen e Partisë Komuniste nuk u gënjeje nga demagogjia që përdorën nazistët. Ai e vazhdoi luftën më me gjallëri kundër pushtuesve të rinj. Nuk kaloi asnjë muaj që hitlerianët të bindeshin se populli shqiptar ishte armik për vdekje i tyre dhe i çdo regjence e qeverie shqiptare kolaboracioniste.

Në vjeshtë të vitit 1943 repartet e njësitë e UNÇSH kryen goditje të fuqishme kundër trupave hitleriane dhe forcave reaksionare në të gjitha anët e vendit. Më 18 tetor artileria e UNÇSH qëlloi asamblenë e kuislingëve të mbledhur me iniciativën e komandës gjermane. Ky aksion u shoqërua me traktin e PKSH që u shpërnda po atë ditë në Tiranë dhe që mbante titullin: «Si i përgjigjet populli shqiptar asamblesë së Gestapos? Me TOP!»<sup>1</sup>.

Krahas luftimeve të UNÇSH në krahinat dhe qytetet e pushtuara zhvillonin veprime të ndryshme diversioni njësitet guerile. Këto veprime u bënë më të shpeshta dhe më të organizuara.

Komiteti Qendror i Partisë tregonte kujdesin më të madh që lufta e armatosur kundër pushtuesve të rinj të bëhej e pandërprerë dhe me ashpërsi në çdo kënd të Shqipërisë. Kur ai mori vesh se Shtabi i Qarkut të Beratit, i drejtuar nga Gjin Marku, kishte lejuar përkohësisht ushtarët gjermanë të hynin

---

1 Thirrje dhe trakte të PKSH 1941-1944, 1962, f. 310.

lirisht në Berat in e çliruar, e cilësoi këtë akt një krim dhe e dënoi ashpër. «Mund të pritnim çdo gjë nga një komandë partizane, — i shkruante në atë kohë shoku Enver Hoxha Shtabit të Qarkut, — por me ardhë në ujdi, qoftë edhe për një minutë, me armikun më të madh të popullit tonë dhe të njerëzimit, këtë nuk na e merrte mendja kurrë... Sikur të gjithë ushtrinë tuaj ta humbisnit, sikur të gjithë punën e fituar ta rrezikonit, *kurrën e kurrës nuk duhej të merreshit vesh me nazistët barbarë!*».

Pas pushtimit të vendit nga trupat gjermane në Shqipëri u krijua një gjendje e re. Tipari kryesor i kësaj gjendjeje ishte grumbullimi rreth pushtuesve të rinj i tërë grupeve, rrymave e forcave reaksionare dhe kalimi i tyre në luftë të hapur e të përgjithshme me armë kundër Lëvizjes Nacionalçlirimtare.

Reaksioni i brendshëm e ndiente veten gjithnjë e më shumë të pazot për t'i bërë ballë gjendjes me forcat e veta. Kjo paaftësi e reaksionit dhe përputhja e qëllimit të tij me qëllimin e pushtuesve gjermanë bënë që tradhtarët shqiptarë të kërkonin hapur përkrahje e mbrojtje te nazistët dhe të vinin forcat e veta nën komandën e tyre.

**Shkatërrimi i reaksionit të brendshëm — kusht për të luftuar me sukses kundër pushtuesve** — Me pushtuesit gjermanë u bashkuan menjëherë Balli

Kombëtar, bajraktarët, kleri i lartë, sidomos katolik, gjithë politikanët fashistë. Krerë të Ballit Kombëtar, të klerit dhe përfaqësues të rrymave të tjera reaksionare hynë në Regjencë, në qeveri dhe në organe të tjera të larta kuislinge.

Tani që Balli Kombëtar, duke u futur thellë në rrugën e tradhtisë, ishte hedhur në luftë të hapur me armë kundër Lëvizjes Nacionalçlirimtare së bashku me nazistët gjermanë, Partia Komuniste dhe Këshilli i Përgjithshëm ishin të detyruar t'i përgjigjeshin kësaj vegle të pushtuesve po me luftë të armatosur. «Bashkimi me Ballin Kombëtar, — udhëzonte Komiteti Qendror i PKSH, — tani është një punë e vdekur dhe

---

1 Letër drejtuar Shtabit të qarkut të Beratit, 5 nëntor 1943. Dokumente të Shtabit të Përgjithshëm..., vëll. I, 1976, f. 145.

s'bisodohet më për atë punë. Tani bisodohet shpartallimi i Ballit Kombëtar»<sup>1</sup>.

Pikërisht në këtë kohë doli hapur edhe tradhtia e Abaz Kupit me zogistët. Pasi kundërshtoi të merrte pjesë në Konferencën e Labinotit, Abaz Kupi dezertoi nga Fronti Nacionalçlirimtar. Ai kishte hyrë në Front me qëllime të caktuara, për të rritur kredinë e Zogut dhe për të penguar rritjen e autoritetit, të ndikimit e të rolit udhëheqës të Partisë Komuniste. Ai pati vepruar gjithnjë sipas porosisë së imperialistëve anglezë, të cilët synonin me anë të zogistëve të siguronin kontrollin e tyre në Lëvizjen Nacionalçlirimtare dhe në Shqipërinë e pasluftës. Meqenëse këtij qëllimi nuk ia arriti dot, në gjendjen e krijuar pas kapitullimit të Italisë, Abaz Kupi kujtoi se kishte ardhur çasti i volitshëm për të asgjësuar Frontin Nacionalçlirimtar dhe Partinë Komuniste. Me ndihmën e anglezëve ai shpalli në shtator formimin e «partisë zogiste», e cila pas një muaji u pagëzua me emrin Legaliteti. Në nëntor mbledhi një të ashtuquajtur kongres të kësaj organizate. Legaliteti i vuri vetes detyrë ta shkëpuste popullin shqiptar nga Partia Komuniste dhe ta bashkonte rreth tij që të rivendoste regjimin e Zogut. Për këtë qëllim zogistët shpërthyen një fushatë të gjerë, duke e propaganduar këtë regjim si të vetmin «legal» dhe duke e idealizuar si një «regjim të lirisë, të qetësisë, të rendit, të paqes e të drejtësisë»! Ata u kërkuan partive të ndryshme politike, duke përfshirë edhe Lëvizjen Nacionalçlirimtare e Partinë Komuniste të mblidheshin nën flamurin e Legalitetit! Në të njëjtën kohë Abaz Kupi i bashkoi forcat e veta me qeverinë kuislinge e me Ballin Kombëtar dhe u mbështet te pushtuesit gjermanë.

Nazistët u treguan të gatshëm për t'i dhënë Abaz Kupit e Legalitetit çdo ndihmë e përkrahje, ndonëse e dinin mirë se ishin vegla të anglezëve. Hitlerianët dhe zogistët i bashkonte synimi i afërt i përbashkët për të shkatërruar Partinë Komuniste dhe për të shuar Lëvizjen Nacionalçlirimtare.

Partia Komuniste u përpoq shumë dhe përdori të gjitha mundësitë për të bindur Abaz Kupin me zogistët të hiqnin dorë nga qëndrimi armiqësor ndaj Lëvizjes Nacionalçlirimtare e të hidheshin në luftë me armë kundër gjermanëve, duke

---

1 Letër e Komitetit Qendror të PKSH, 1 tetor 1943. Dokumente kryesore të PPSH, vëll. I, f. 211.

genë të përfshirë në Frontin Nacionalçlirimtar. Pas shpalljes së Legalitetit ajo e bëri edhe një herë të qartë se nuk ishte kundër krijimit të një partie zogiste ose të një partie tjetër politike në vend. Por çdo parti që do të krijohej duhej me- doemos të luftonte kundër pushtuesit dhe të merrte pjesë në Frontin e përbashkët Nacionalçlirimtar.

Në rrethanat konkrete asnjë parti, asnjë organizatë dhe asnjë forcë e armatosur jashtë Frontit nuk qëndronte dot asnjane- së, do t'i shërbente patjetër armikut. Prandaj edhe të gjitha përpjekjet e Abaz Kupit për të zbatuar porosinë e anglezëve që të mos binte në sy si bashkëpunëtor i pushtuesve gjermanë ishin të kota. Në fillim të dhjetorit Këshilli i Përgjithshëm Nacionalçlirimtar, pasi shqyrtoi veprimtarinë kriminale anti- kombëtare të Abaz Kupit, vendosi zyrtarisht përjashtimin e tij nga Këshilli dhe Shtabi i Përgjithshëm. Në të njëjtën kohë porositi të demaskohej ai si armik i popullit shqiptar dhe Legaliteti si një organizatë tradhtarë.

Kalimi i gjithë reaksionit në luftë të hapur me armë kundër UNÇSH dhe Frontit Nacionalçlirimtar së bashku me pushtuesit gjermanë tregonte që ishte kryer një diferencim i thellë i forcave politiko-klasore të brendshme. Lëvizja revolu- cionare i shoshiti këto forca dhe i ndau në dy blloqe, armiq për vdekje me njëri-tjetrin. Në njërën anë shumica dërrmuese e popullit shqiptar — klasa punëtore, fshatarësia e varfër dhe e mesme, borgjezia e vogël dhe pjesa më e madhe e bor- gjezisë së mesme të qytetit, intelektualët patriotë, të bashkuar dhe të organizuar në Frontin Nacionalçlirimtar nën udhëhe- qjen e Partisë Komuniste. Fronti bazohej në masat popullore të armatosura dhe kishte si forcë kryesore sulmuese Ushtrinë Nacionalçlirimtare e si mbështetje të jashtme luftën botërore antifashiste, në radhë të parë Luftën e madhe Patriotike të Bashkimit Sovjetik. Në anën tjetër — klasa e çifligarëve, bajraktarët, borgjezia reaksionare, shumica e fshatarëve të pa- sur, pjesa reaksionare e intelektualëve dhe e klerit, të grum- bulluar në organizata dhe në grupe heterogjene, pa lidhje të shëndoshë midis tyre. Reaksioni kishte si forcë të armatosur repartet e xhandarmërisë dhe bandat e ballistëve, zogistëve dhe bajraktarëve. Organizatat dhe forcat e armatosura reak- sionare nuk përbënin një bllok më vete të pavarur, ato ishin një pjesë e frontit hitlerian dhe mbaheshin më këmbë krye- sisht me ndihmën e pushtuesve.

Në këto rrethana Partia Komuniste lëshoi direktivën për të shkatërruar me armë organizatat dhe forcat e armatosura reaksionare jashtë Frontit Nacionalçlirimtar, duke e quajtur luftën kundër reaksionit pjesë përbërëse të luftës së përgjithshme kundër pushtuesve. Shtabi i Përgjithshëm u dha urdhër reparteve e njërive partizane të spastronin nga reaksionarët të gjitha krahinat e çliruara. Nuk mund të luftohej me sukses dhe të arrihej fitorja kundër nazistëve gjermanë, pa luftuar njëkohësisht edhe kundër shërbëtorëve të tyre.

Masat e gjera popullore e përkrahën menjëherë qëndrimin e Partisë për shkatërrimin e Ballit Kombëtar, të Legalitetit dhe të forcave të tjera reaksionare. Ato e kërkonin vetë një gjë të tillë, sepse ishin bindur nga përvoja për tradhtinë e këtyre organizatave.

Duke qenë e detyruar të luftonte me armë kundër Ballit Kombëtar e Legalitetit, PKSH nuk hoqi dorë nga vija e saj e përgjithshme e caktuar në Mbledhjen për themelimin e saj e në Konferencën I të Vendit. Ashtu si më parë, u ruajt i paprekur karakteri nacionalçlirimtar i luftës dhe parimi i bashkimit në Frontin Nacionalçlirimtar të të gjithë popullit shqiptar pa dallim klase, bindjeje politike, feje dhe krahine. Dyert e Frontit mbetën të hapura edhe për ata ballistë, zogistë e xhandarë që nuk i kishin lyer duart me gjak dhe që largoheshin nga radhët e organizatave e forcave të armatosura reaksionare. U dhanë udhëzime të bëheshin pa pushim përpjekje për të shkëputur nga krerët tradhtarë njerëzit e mashtruar.

Mbi të gjitha Partia tregonte një kujdes të vazhdueshëm të mos dobësohej lufta kundër pushtuesve gjermanë, që mbeleshin gjithnjë armiku kryesor, dhe të mos shndërrohej ajo në luftë civile, të cilën e nxisnin me çdo mënyrë skllavëruesit hitlerianë, siç e patën nxitur më parë edhe fashistët italianë.

### **Asnjë ndërhyrje të jashtme në punët e Luftës Nacionalçlirimtare**

Në vjeshtë të vitit 1943 Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare e popullit shqiptar u ndesh edhe me një rrezik

tjetër që vinte nga aleatët anglo-amerikanë.

Që nga maji i vitit 1943 kishin ardhur në Shqipëri (pa u ftuar) përfaqësues të komandës anglo-amerikane të Mesdheut. Një mision ushtarak britanik u vendos pranë Shtabit të Për-

gjithshëm, kurse më vonë edhe një mision ushtarak amerikan. Oficerë anglezë ndodheshin gjithashtu pranë disa komandave partizane. Ata e paraqitën ardhjen e tyre në Shqipëri si të diktuar nga interesi i përbashkët ushtarak për luftën kundër hitlerianëve dhe morën përsipër, me fjalë, të ndihmonin UNÇSH me armë dhe materiale të tjera luftarake të nevojshme. Në të vërtetë ata erdhën në Shqipëri me qëllime kryesisht politike. Të nisur nga këto qëllime, ata zhvilluan një veprimtari minuese dhe u bënë pengesë për luftën kundër pushtuesve e veglave të tyre në Shqipëri. Anglo-amerikanët ndihmën më të madhe ua dhanë kundërshtarëve të Lëvizjes Nacionalçlirimtare, forcave reaksionare. Ata vendosën pranë këtyre forcave misione të posaçme ushtarake dhe i furnizonin me armë, municione, veshmbathje e me flori. Kur Balli Kombëtar dhe Legaliteti u bashkuan me gjermanët kundër Frontit Nacionalçlirimtar, misionet ushtarake anglo-amerikane as u larguan prej tyre, as u prenë ndihmat. Komanda e trupave anglo-amerikane të Mesdheut filloi të ushtronte presion të madh mbi Shtabin e Përgjithshëm që të mos kryhej asnjë goditje kundër forcave reaksionare. Ajo kërkoi t'u njihej oficerëve anglezë e amerikanë roli i arbitrit në punët e brendshme të popullit shqiptar.

Si u vërtetua në praktikë, qeveritë e Britanisë së Madhe dhe të SHBA nuk kishin aspak qëllim të ndihmonin me të vërtetë lëvizjet nacionalçlirimtare në Ballkan. Ato synonin vetëm të mos lejonin fitoren e forcave popullore revolucionare, të asgjësonin autoritetin dhe ndikimin e partive komuniste, të vendosnin kontrollin anglo-amerikan në vendet ballkanike.

Partia Komuniste e cilësoi ndërhyrjen anglo-amerikane një rrezik për fitoren e revolucionit dhe për pavarësinë kombëtare dhe mori pa asnjë ngurrim një qëndrim të prerë kundër kësaj ndërhyrjeje. Nëpërmjet Shtabit të Përgjithshëm iu bë një paralajmërim i prerë misionëve aleate për të hequr dorë nga përzjerja në punët e brendshme politike e ushtarake të Shqipërisë dhe për të mos penguar zhvillimin e luftës së popullit shqiptar kundër pushtuesve hitlerianë e shërbëtorëve të tyre. Të gjithë oficerët britanikë dhe amerikanë që do të vazhdonin të qëndronin pranë forcave reaksionare do të quheshin armiq. Misionet ushtarake aleate, i udhëzonte Komiteti Qendror komitetet qarkore të partisë, «nuk duhet të përzihen në punët e brendshme, nuk duhet në asnjë mënyrë të merren si

arbitra ndërmjet nesh dhe reaksionit. Në u pëlqeftë lufta jonë kundër reaksionit mirë, përndryshe derën e kanë të hapur»<sup>1</sup>.

Çdo përfaqësues aleat që nuk do të respektonte parimin e mosndërrhyrjes në punët e brendshme do të përcillej i shoqëruar në Shtabin e Përgjithshëm dhe pastaj do të dëbohej jashtë tokës shqiptare.

Ky qëndrim revolucionar i prerë dhe i drejtë ndaj aleatëve anglo-amerikanë pati një rëndësi shumë të madhe për zhvillimin e mëtejshëm të Luftës Nacionalçlirimtare dhe për fatin e revolucionit popullor.

### **Në radhë të parë forcimi i pushtetit dhe i UNÇSH**

Forcimi i pushtetit revolucionar dhe i Ushtrisë Nacionalçlirimtare kishte rëndësi vendimtare jo vetëm për shkatërrimin e planeve të pushtuesve të rinj gjermanë e të tradhtarëve, por edhe të planeve kundërrevolucionare që anglo-amerikanët do të përpiqeshin të vinin në zbatim në rast zbarkimi të trupave të tyre në Shqipëri ose me anë të agjenturave e të misioneve të tyre ushtarake.

Pasi dështoi orvatja shumë e rrezikshme që u bë në Mukje për të minuar pushtetin e këshillave dhe rolin udhëheqës të Partisë Komuniste, reaksioni vuri në përdorim mjete të reja për shkatërrimin e këtij pushteti. Këshillat nacionalçlirimtarë do të asgjësoheshin me anë të forcës së armatosur. Në vend të tyre do të rivendosej pushteti i vjetër çifligaro-borgjez me lejen dhe përkrahjen e pushtuesve gjermanë. Nazistët e mbështetën pa asnjë kundërshtim idenë e regjimit të Zogut që nxori në shesh Legaliteti. Këtë e tregonin qartë krijimi prej tyre i «Regjencës» kuislinge, vënia e zogistëve në poste të rëndësishme në qeverinë dhe xhandarmërinë kolaboracioniste, liria që gëzonte Legaliteti për të botuar e për të shpërndarë organet e tij të shtypit dhe për të ushtruar veprimtarinë e vet në qytetet dhe krahinat e pushtuara nga trupat gjermane. Rivendosjen e regjimit të Zogut e mbështetën sidomos qeveritë britanike e amerikane. Në këtë kohë Çurçilli zhvilloi bisedime në Londër me Zogun për krijimin e një qeverie mbretërore shqiptare në mërgim.

---

<sup>1</sup> Direktiva e KQ të PKSH, 3 nëntor 1943. Dokumente kryesore të PPSH, vëll. I, f. 232.



Këtyre manovrave u dhanë grusht dërrmues Partia Komuniste dhe populli shqiptar. Përpara kësaj gjendjeje Komiteti Qendror i Partisë udhëzonte: «Në radhë të parë na paraqitet çështja e pushtetit..., vendosja kudo e këshillave nacionalçlirimtarë, forcimi i tyre dhe mbrojtja e tyre nga çdo tentativë e Ballit ose e ndonjë partie tjetër, që do të përpiqet t'i sabotojë ose t'i luftojë haptazi. Për këtë punë nuk duhet të ketë dy kuptime: vetëm pushteti i këshillave duhet të ekzistojë dhe asnjë pushtet tjetër, nuk ka kompromis dhe dualitet në këtë gjë»<sup>1</sup>. Komitetet qarkore të Beratit dhe të Gjirokastrës u kritikuan ashpër, sepse nuk morën masa të menjëhershme pas kapitullimit të Italisë fashiste për të shkatërruar aparatën e pushtetit të vjetër në këto qytete të çliruara, por lejuan që ky aparat të vihej nën kontrollin e Ballit Kombëtar dhe të përdorej prej tij. Pas kësaj kritike ky gabim u ndreq përnjëherësh, sipas porosisë së Komitetit Qendror.

Organizatat e partisë zhvilluan një propagandë e agjitacion të gjerë për demaskimin e regjimit të vjetër, si një regjim mjerimi dhe shtypjeje. Ato ua bënë edhe më të qartë masave popullore se pushtetin politik nuk ta liron as ta fal kush, po s'e rrëmbeve me forcë, se populli shqiptar do të vendosë vetë fatin e tij me armët që ka në dorë e nuk do të lejojë t'i imponohet regjimi i Zogut, se anglezët e amerikanët nuk kanë asnjë të drejtë të përzihen as në çështjen e regjimit, as në punët e tjera politike e ushtarake të popullit shqiptar.

Për forcimin e pushtetit popullor u morën një varg masash në bazë të vendimeve të Konferencës II Nacionalçlirimtare, të Statutit e të Rregullores së këshillave që u miratuan në Konferencë. Në të gjitha qytetet dhe krahinat e çliruara u organizua zgjedhja e këshillave të reja nacionalçlirimtarë, në disa qarqe u mbajtën konferenca nacionalçlirimtare të qarikut. Këshillat u spastruan nga njerëzit e lëkundshëm. Përbërja e tyre u rrit dhe u forcua. Veprimtaria qeverisëse e Këshillit të Përgjithshëm, e këshillave të qarqeve, krahinave dhe qyteteve të çliruara, me ngritjen e organeve ekzekutive e të aparatit administrativo-ekonomik pranë tyre, u përmirësua dhe u gjallërua.

---

<sup>1</sup> Letër e KQ të PKSH, 1 tetor 1943. Dokumente kryesore të PPSH, vëll. I, f. 204.

Në gjithë veprimtarinë e vet këshillat nacionalçlirimtarë kishin mbështetjen e fortë të masave popullore.

Bashkimi i masave popullore rreth Partisë dhe këshillave nacionalçlirimtarë u çimentua edhe më shumë me ngritjen e këshillave të Rinisë Antifashiste dhe të Gruas Antifashiste në gjithë vendin.

Problem kryesor i Luftës Nacionalçlirimtare, prej të cilit varej siguri i pavarësisë kombëtare dhe vendosja e pushtetit popullor, mbetej forcimi i ushtrisë. Sipas udhëzimeve të Komitetit Qendror, në vjeshtë të vitit 1943, në Ushtrinë Nacionalçlirimtare hyri shumica e anëtarëve të partisë dhe e të rinjve komunistë. Thirrjes së Partisë Komuniste për të shtuar radhët e reparteve e të njëjseve partizane iu përgjigjën me mijëra të rinj nga radhët e fshatarëve, të punëtorëve e të nxënësve.

Që nga 10 korriku 1943 UNÇSH u rrit dyfish. Në vjeshtë u formuan dy brigada të reja sulmuese (e Dyta dhe e Treta).

Shtabi i Përgjithshëm udhëhiqte veprimet luftarake, drejtonte dhe ndiqte me kujdes zbatimin e planeve të tij për formimin e brigadave, grupeve e batalioneve të reja, për përgatitjen e kuadrove e për sigurimin e ushqimeve dhe të veshmbathjes për dimër. Ai i kritikonte dhe i vinte në udhë të drejtë ato komanda partizane që shkelnin ose nuk zbatonin me mjeshtëri kërkesat e luftës revolucionare partizane. Nga gabimet që bëheshin në repartet dhe njësitë nxirrte mësim të vlefshme dhe ua shpërndante gjithë shtabeve e komandave për t'i zbatuar. Shtabi i Përgjithshëm kritikoi ashpër sidomos disa komanda që nuk sulmonin, por e prisnin armikun në pozicione. Mësime të rëndësishme nxori ai nga orvatjet e komandave gjermane për të vënë në zbatim taktikën e luftës kundërpazitane. Masat që u morën bënë të dështonte krejt ky plan i armiqve. Gjithashtu dështuan përpjekjet e nazistëve gjermanë për të gozhduar repartet partizane në luftë frontale.

Zhvillimi me sukses i luftës kundër pushtuesve të rinj gjermanë, zgjerimi dhe forcimi i pushtetit popullor e rritën edhe më shumë autoritetin e Partisë Komuniste të Shqipërisë. Orvatjet e hitlerianëve, të reaksionit të brendshëm dhe të reaksionit imperialist anglo-amerikan për të veçuar Partinë nga populli dështuan. Masat popullore u bënë edhe më të ndërjegjeshme për nevojën e luftës pa kompromis kundër armikut deri në fitoren përfundimtare.

Ishte e natyrshme që pushtuesit gjermanë dhe tradhtarët të mos pajtoheshin me këtë gjendje, që ata të vinin të tëra forcat për ta ndryshuar atë në dobi të tyre, duke goditur pa mëshirë Partinë Komuniste dhe UNÇSH.

Komiteti Qendror i porosiste organizatat e partisë të mos deheshin aspak nga sukseset, ta shikonin me sy objektiv e ta kuptonin drejt gjendjen, të kishin mendjen të mos ziheshin në befasi, të përgatiteshin vetë, të përgatisnin partizanët dhe gjithë popullin për të përballuar vështirësitë e mëdha që qëndronin përpara. Mbi të gjitha kërkohej të ishte e çeliktë Partia. «Barra që rëndon mbi supet e Partisë sonë është jashtëzakonisht e rëndë dhe për ta ngritur këtë barrë e për të dalë manta në fitimtarë, duhet të kemi kockën e kurrizit të shëndoshë, duhet të kemi Partinë tonë të organizuar e të fortë, duhet t'i kemi shokët në lartësinë e duhur politike dhe ushtarake, që të mundin në këto momente e situata të vështira e decizive të përballin çdo të papritur dhe të orientohen pa u gabuar»<sup>1</sup>.

## 7. PKSH ORGANIZATORE E LUFTËS HEROIKE TË POPULLIT SHQIPTAR PËR ASGJËSIMIN E PLANEVE TË ARMIKUT NË DIMRIN 1943-1944

Për të asgjësuar Partinë Komuniste, Lëvizjen Nacionalçlirimtare dhe forcën e tyre të armatosur — Ushtrinë Nacionalçlirimtare, pushtuesit gjermanë vendosën të organizonin me ndihmën e tradhtarëve një mësymje ushtarake të përgjithshme.

### **Dështimi i mësymjes së përgjithshme armike të dimrit**

Në këtë mësymje komanda gjermane përdori drejtpërdrejt katër divizione dhe disa mijëra ballistë e zogistë, gjith-

sej rreth 45 mijë veta.

UNÇSH kishte në këtë kohë rreth 20 mijë luftëtarë. Por duke ditur se kundërshtar kishin gjithë popullin e jo vetëm

---

<sup>1</sup> Direktiva e KQ të PKSH, 3 nëntor 1943. Dokumente kryesore të PPSH, vëll. I, f. 231.